10. Një mësimdhënës për lëndët: Onkologji klinike (O), Kanceri i gjirit (Z).
11. Një mësimdhënës për lëndët: Gnatologji/O/BSc (O), Materialet në Stomatologji/O/BSc (O), Protetika Fikse (Paraklinika) (O), Protetika mobile (Paraklinika) (O).
12. Një mësimdhënës për lëndët: Bazat e Farmacisë (O), Bazat e sintezës dhe nomenklaturës së barnave (O), Farmakogjentika (Z), Praktika në barnatore (Praktika Klinike) (O).
13. Një mësimdhënës për lëndët: Pediatri (MP) (O), Kujdesi infermieror i fëmijëve dhe Pediatria (O), Gjenetika Mjekësore (O), Pediatria (Praktika klinike) (O), Menaxhimi i integruar i fëmijëve (Z), Kujdesi infermieror për fëmijët me sëmundje kronike (Z).
14. Një mësimdhënës për lëndët: Anatomi II MP (O), Anatomi Klinike e sistemit lokomotor FT (O), Teknikat Imazherike në hulumtimet shkencore, PhD (Z), Anatomi I, MP (O), Anatomi Klinike II (Z).
15. Një mësimdhënës për lëndët: Anesteziologji dhe Reanimacion (O), Anesteziologji dhe Reanimacion (O), Mjekësia Urgjente (Z), Mjekësia Urgjente – viti VI-të (MP) (Z), Kujdesi infermieror emergjent dhe Kujdesi shëndetësor në rastet urgjente (O), Reanimimi kardiopulmonar (O), Trajtimi i dhembjes akute dhe kronike (Z), Kujdesi infermieror në mjekimin intensiv (L.Z.I) (Z), Kujdesi Paliativ (Z).
16. Tre asistentë për lëndët: Anatomi II (ST) (O), Anatomi II (MP) (O), Anatomi I (F) (O), Anatomi I (MP) (O).
17. Dy asistentë për lëndët: Mjekësi fizikale dhe rehabilitim (MP) (O), Mjekësi Fizikale (Praktikë klinike) (MP) (O), Mjekësi fizikale dhe rehabilitim (Ft) (O), Mjekësi fizikale dhe rehabilitim (S) (O).
18. Tre asistentë për lëndët: Pedodonica (O), Pedodonica (Praktikë klinike) (O).
19. Tre asistentë për lëndët: Otorinolaringologjia (O), ORL – Kirurgjia e kokës dhe qafës (Praktika klinike) (O), ORL (O).
20. Katër asistentë për lëndët: Kirurgji Orale (Praktikë Klinike) (O), Kirurgji Orale klinike (O).
21. Dy asistentë për lëndët: Ortopedi (O), Ortopedi, Praktikë Klinike (O).
22. Dy asistentë për lëndët: Protetika Fikse (Paraklinika) (O), Protetika mobile (Paraklinika) (O).
23. Një asistent për lëndët: Parodontologji (O), Parodontologji – Praktikë klinike (O).
24. Dy asistentë për lëndët: Neurologji, MP (O), Neuropsikiatri, St (O), Psikologji dhe shkathtësi komunikimi, MP (O), Neurologji dhe psikiatri, Mësimi klinik, MP (O), Infermiera Psikiatrike dhe Shëndeti Mendor I (O).
25. Dy asistentë për lëndët: Psikiatria, MP (O), Neuropsikiatria, (S) (O), Neurologji dhe Psikiatri (Praktikë Klinike) (O).

26. Tre asistentë për lëndën Fiziologjia Patologjike (St) (MP) (O).
27. Dy asistentë për lëndët: Gjinekologji dhe Obstetrike (O), Gjinekologji dhe Obstetrike, Praktikë Klinike (O).
28. Dy asistentë për lëndën Dermatovenerologjia (MP) (O).
29. Një asistent për lëndët: Epidemiologji (MP) (O), Epidemiologji (Praktikë klinike) (O).
30. Tre asistentë për lëndët: Kirurgji (MP) (O), Kirurgji (Stom) (O), Kirurgji (MP) (Praktikë klinike) (O).
31. Dy asistentë për lëndët: Sëmundjet Infektive (O), Sëmundjet Infektive (O), Sëmundjet Infektive (Praktikë klinike) (O).
32. Dy asistentë për lëndët: Radiologji (O), Radiologji (O), Radiologjia në Infermieri (O).
33. Një asistent për lëndët: Mjekësi Interne-Pulmologji (MP) (O), Pulmologjia (Praktikë klinike) (MP) (O).

X. FAKULTETI I ARTEVE

Avancime ose riemërime:

1. Një mësimdhënës për lëndët: Analizë e tekstit (BA) (O), Histori e dramës dhe teatrit botëror I-II (BA) (O), Radio dramë (BA) (O).
2. Një mësimdhënës për lëndët: Dramaturgji (BA) (O), Dramatologji (BA) (O).
3. Një mësimdhënës për lëndët: Nudo I, II (BA) (O), Vizatim kinetik I, II (BA) (O).
4. Një mësimdhënës për lëndët: Skulpturë I, II, III, IV (BA) (O), Skulpturë (MA) (O).

Emërime për herë të parë në thirrjen përkatëse:

5. Një mësimdhënës për lëndët: Dizajn Skene III (BA) (O), Dizajn Skene IV (BA) (O), Dizajn i produksionit (BA) (O), Produksion teknik i skenografisë dhe kostumgrafisë (BA) (Z).
6. Një mësimdhënës për lëndët: Elementet e dizajnit I (BA) (O), Elementet e dizajnit II (BA) (O), Dizajn eksperimental I (BA) (O), Dizajn eksperimental II (BA) (O), Tipografi (BA) (O).
7. Një mësimdhënës për lëndët: Regji filmi II (BA) (O) dhe Regji filmi në Programe (O).
8. Një mësimdhënës për lëndët: Solokëndim instrument i dytë (BA) (O), Teknikë vokale (BA) (O).
9. Një mësimdhënës për lëndët: Bazat e produksionit filmik (BA) (O), Puna me aktor (BA) (O).
10. Një mësimdhënës për lëndët: Bazat e produksionit televiziv dhe radio (BA) (O), Efektet digjitale dhe postproduksion (BA) (Z), Teknologjia në film dhe televizion (BA) (Z).
11. Një mësimdhënës për lëndët: Kamerë dhe fotografi I (BA) (O), Kamerë dhe fotografi II (BA) (O), Kamerë dhe fotografi III (BA) (O).
12. Një mësimdhënës për lëndët: Teori e hapësirës I (BA) (O), Teori e hapësirës II (BA) (O), Art Publik I (BA) (O), Art Publik II (BA) (O).
13. Një asistent për lëndët: Regji filmi I (BA) (O), Regji filmi II (BA) (O), Regji filmi III (BA) (O), Regji filmi IV (BA) (O).
14. Një asistent për lëndët: Analizë e dizajnit dhe inovacioneve (BA) (O), Metodologji e dizajnit (BA) (O), 3D modelim dhe renderim I (BA) (O), Dizajn i integruar (BA) (O).

XI. FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

Avancime ose riemërime:

1. Një mësimdhënës për lëndët: Bazat e Pemëtarisë (O), Pemëtaria speciale (O), Hyrje në shkencat pemëtare vreshtare (O), Agropomoteknika (O), Projekte interdisciplinare në pemëtarë dhe vlerësimi i pemëve (O), Natyra e fidanishteve të pemëve (Z).

Emërime për herë të parë në thirrjen përkatëse:

2. Një mësimdhënës për lëndët: Fisnikërimi i pemëve dhe hardhisë së rrushit (Z), Seleksionimi në hortikulturë dhe bimë frutore (O), Prodhimtaria e veçantë e frutave (O), Kultivimi Organik i Pemëve dhe Hardhisë (O), Biologjia dhe ekologjia e pemëve (Z), Florikulturë (Zingjiri i furnizimit më bimë) (Z).
3. Një mësimdhënës për lëndët: Kimi fizike (BSc. TUBT) (O), Kimi (MV), (O), Kimi e Përgjithshme dhe inorganike (BSc. TUBT) (O), Bazat e Kimisë (BSc. AE), (O).
4. Një mësimdhënës për lëndët: Kimi dhe Biokimi (BSc. PB), (O), Praktikum i Kimisë Analitike (BSc. TUBT) (O), Kimi dhe Biokimi (BSc. MBZ), (O).
5. Një mësimdhënës për lëndët: Vlerësimi Ekonomik i Mallrave të Tregut dhe Burimeve Natyrore (Msc. A.E) (O), Mjetet dhe metodat e menaxhimit dhe zhvillimit rural (Msc. A.E) (O), Sigurimi i ushqimit dhe resurseve natyrore (Bsc. A.E) (O), Menaxhim i Projekteve (Bsc. AE) (O), Hyrje në Ekonominë Qarkulluese (Msc. A.E) (Z).
6. Një mësimdhënës për lëndët: Sëmundjet e brendshme II (O), Kirurgjia II (O), Sëmundjet e Kafshëve të Shoqërimit (O), Oftalmologji Veterinare (O), Procedura special operative në kirurgjinë e indeve të buta (Z), Kali në këndin e vrojtimit të nallbanëve (Z), Tema special dhe demonstrime në kafshët e vogla (Z).
7. Një asistent për lëndët: Mjetet dhe metodat e zhvillimit dhe menaxhimit rural (Msc. A.E) (O), Menaxhimi i biznesit në fermë II (Msc.A.E) (O), Politikat Bujqësore dhe të Ushqimit II (Msc.AE) (O), Menaxhimi i Fermës dhe Agrobiznesit (Bsc.AE) (O), Menaxhimi i projekteve (Bsc.AE) (O), Bazat e ekonomisë (Bsc.AE) (O), Ekonometria II (Msc.AE) (O), Analizë statistikore (Bsc.AE) (O), Organizimi, marketingu dhe menaxhimi i sektorit të ushqimit (Bsc.AE) (O), Ekonomia e ndërmarrjes dhe marketingu (Bsc. TUBT) (O).

XII. FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT

Emërime për herë të parë në thirrjen përkatëse:

1. Një mësimdhënës për lëndët: Fiziologjia e Ushtrimeve dhe Sportit (O), Fiziologjia e Avancuar Sportive (O), Fiziologjia e Avancuar e Ushtrimeve (O), Preventiva e lëndimeve në sport (Z).
2. Një mësimdhënës për lëndët: Noti (O), Procesi stërvitor në Not (Z), Aktivitete në ujë dhe siguria (Z), Zhvillimi i sportistëve të talentuar zhvillimi bio-psiko-social (O).
3. Një mësimdhënës për lëndët: Vallëzim (O), Gjymnastikë ritmike (O).
4. Një mësimdhënës për lëndët: Kineziologji (O), Kinezoterapi (O).

XIII. FAKULTETI I EDUKIMIT

Avancime ose riemërime:

1. Një mësimdhënës për lëndët: Mësimdhënia dhe të nxënit elektronik (O), Shfrytëzimi i teknologjisë në edukim (O), Cloud Computing në Edukim (O), TIK-u për edukatore (O), Praktika Pedagogjike 2 (O).

Emërime për herë të parë në thirrjen përkatëse:

2. Një mësimdhënës për lëndët: Pedagogji e Përgjithshme (O), Pedagogji Familjare (O), Histori e Edukimit Kombëtar (Z), Histori e Pedagogjisë Kombëtare (O), Praktikum i punës së pedagogut (O).
3. Një mësimdhënës për lëndët: Të nxënit përmes lojës (Z), Partneriteti me familjen dhe komunitetin (Z), Edukimi në fëmijërinë e hershme (Z), Praktika Pedagogjike III (O).
4. Një mësimdhënës për lëndët: Strategjitë bashkëkohore të mësimdhënies (Z), Teoria e mësimit dhe kurrikulës (O), Teoria e mësimit dhe kurrikulës (O), Sistemi i arsimit në Kosovë (O), Menaxhimi i klasës (O).
5. Një mësimdhënës për lëndët: Praktika bashkëkohore në edukimin inkluziv (O), Mësimdhënia e diferencuar dhe plani individual i edukimit (PIE) (Z), Vështirësitë në të nxënë (Z), Pedagogji speciale (O), Praktikë Pedagogjike (O).
6. Një mësimdhënës për lëndët: Vendimmarrja e bazuar në dëshmi (Z), Mësimdhënësi hulumtues (Z), Zhvillimi profesional i mësimdhënësve (O), Bazat e hulumtimit në edukim (O), Metodot e hulumtimit kualitativ (O), Seminar hulumtimi (O).
7. Një mësimdhënës për lëndët: Metodologji e leximit letrar (Z), Interpretimi i tekstit letrar (Z), Shkrimi akademik (Z), Praktika Pedagogjike 1 (O), Hulumtimi në veprim (O).
8. Një mësimdhënës për lëndët: Të nxënit interdisciplinar në Biologji (Z), Të nxënit e biologjisë në natyrë (Z), Historiku i zhvillimit të mendimit biologjik (Z), Praktika Pedagogjike 1 (O), Praktika Pedagogjike 3 (O).
9. Një mësimdhënës për lëndët: Mësimdhënia dhe të nxënit e Gjeografisë Fizike (O), Gjeografia Kombëtare (Z), Mësimi kabinetik dhe puna në terren (Z), Lëvizja hapësinore e popullsisë (Z), Praktika Pedagogjike 3 (O).
10. Një mësimdhënës për lëndët: Mësimdhënia dhe të nxënit e Fizikës 1 (O), Mësimdhënia e Fizikës së energjive të rinovueshme (Z), Vlerësimi dhe të nxënit në lëndën e Fizikës (O), Të nxënit interdisciplinar në Fizikë (Z), Të nxënit e Fizikës në natyrë (Z), Praktika Pedagogjike 1 (O).
11. Një mësimdhënës për lëndët: Sigurimi i cilësisë në institucionet arsimore (Z), Politikat arsimore dhe legjisllacioni (O), Politikat arsimore dhe legjisllacioni (Z), Seminar hulumtimi (O).
12. Një asistent për lëndët: Edukimi në fëmijërinë e hershme 0-3 (O), Edukimi në fëmijërinë e hershme 3-6 (O), Vlerësimi në fëmijërinë e hershme (O), Standardet dhe kompetencat profesionale (O), Edukimi në fëmijërinë e hershme (O), Praktika bashkëkohore në edukim inkluziv (O), Vështirësitë në të nxënë (O), Vështirësitë në të folur (O), Puna në komunitet (O), Teori e edukimit (O).
13. Një asistent për lëndët: Zhvillimi profesional i mësimdhënësve (O), Mentorimi dhe vlerësimi i performancës (O), Metodot e hulumtimit kualitativ (O), Pedagogji shkollore me punë praktike (O), Planifikimi dhe vlerësimi në arsim (O), Metodot e hulumtimit kuantitativ (O), Bazat e hulumtimit në edukim (O), Praktikum i punës së pedagogut (O), Arsimimi i të rriturve (O), Metodikë me punë praktike (O).

XIV. FAKULTETI I ARKITEKTURËS

Avancime ose riemërime:

1. Një mësimdhënës për lëndët: Planifikimi Urbanistik 1 (O), Planifikimi urbanistik dhe mbrojtja e mjedisit (O), Hyrje në Urbanizëm (O), Planifikimi I Qëndrueshëm Urban 1 (O), Planifikimi i Qëndrueshëm Urban 2 (O), Planifikimi Strategjik Hapësinor – Studio (O).

Emërime për herë të parë në thirrjen përkatëse:

2. Një mësimdhënës për lëndët: Projektim 6 (O), Shkencat Humane dhe Arkitektura (Z), Projektim – Qendrat e Komunitetit (Z), Projektim – Objektet Polifunkionale (O), Projektimi në Kontekst Kulturor (Z), Superstrukturat Organike në Projektim (O).
3. Një mësimdhënës për lëndët: Hyrje në Urbanizëm (O), Sociologjia Urbane (Z), Planifikimi dhe Turizmi Kulturor (Z), Planifikimi i Zhvillimit Rural dhe i Turizmit – Studio (O), Metodologjia e Hulumtimit Urban (O), Qytetet e Zgjuara (Z).
4. Një mësimdhënës për lëndët: Teoria dhe Praktika e Restaurimit (O), Historia e Arkitekturës – Koha e Re (O), Diskurset e Arkitekturës (Z), Regjenerimi Urban (Z), Konservimi Urban (O), Trashëgimia Kulturore e Kosovës (O).
5. Një asistent për lëndët: Historia e Arkitekturës - Renesanca deri te Moderna (O), Teoria dhe Kriticizmi në Arkitekturë (O), Mbrojtja e Trashëgimisë Arkitekturale (O), Teoria dhe Praktika e Restaurimit (O).
6. Një asistent për lëndët: Urbanizmi 1 (O), Planifikim urbanistik 1 (O), Planifikim hapësinorë (O), Bazat e Urbanizmit (O), Urbanizmi 2 (O), Planifikimi urbanistik dhe Mbrojtja e Mjedisit (O).

XV. FAKULTETI JURIDIK (Promovimi i “kthimit të trurit”)

Emërime për herë të parë në thirrjen përkatëse:

Pozita të reja sipas nenit 15 (Promovimi i “kthimit të trurit”) të Rregullores me nr. prot. 886, datë 27.4.2022, për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UP dhe Rregullores me nr. prot. 1/292, datë 29.5.2023, për plotësimin, ndryshimin dhe zbatimin e nenit 15 të Rregullores me nr. prot. 886, datë 22.4.2022:

1. Dy asistentë për grup lëndësh në Katedrën Penale
2. Dy asistentë për grup lëndësh në Katedrën Civile
3. Dy asistentë për grup lëndësh në Katedrën Kushtetuese – Administrative
4. Dy asistentë për grup lëndësh në Katedrën Ndërkombëtare
5. Një asistent për grup lëndësh në Katedrën Financiare
6. Një asistent për lëndët interdisiplinare (Hyrje në të Drejtën (O), E Drejta e Barazisë Gjinore (Z), E Drejta e KEDNJ-së (Z), Drejtësia Tranzicionale (Z), Theory and Practice of Human Rights (O, Master), Introduction to Transitional Justice (O, Master)).

KRITERET E VEÇANTA për pozitat nën nr. XV (1-6), në Fakultetin Juridik:

- a. Në konkurs mund të aplikojnë dhe zgjedhën vetëm kandidatët të cilët kanë përfunduar një nivel të studimeve në njërin nga 400 universitetet me të mira sipas World University Rankings (<https://www.topuniversities.com/qs-world-university-rankings>).
- b. Kandidatët përveç tjerash, duhet të dorëzojnë edhe një arsyetim të profilit të programit të studimit, përshkrim të lëndëve, fushës së specializimit së tyre, si dhe të dhëna të tjera që mund të jenë relevante për pozitën në të cilën kanë aplikuar.
- c. Nuk mund të zgjedhën emërohen sipas procedurës së përcaktuar në nenin 15 të rregullores, kandidatët që kanë ose kanë pasur deri në 2 vitet e fundit të punësuar në njësinë akademike përkatëse, persona në marrëdhënie familjare. Marrëdhënie familjare me qëllim të parandalimit të konfliktit të interesit dhe nepotizmit konsiderohet raporti - bashkëshort ose person që bashkëjeton, i afërm në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërm në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adaptues, të adaptuar, në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë.
- d. Pas kalimit të afatit prej 15 ditëve nga shpallja/publikimi i raportit, kandidatët e pakënaqur mund të paraqesin ankesë në afat prej 7 ditëve. Ankesat dorëzohen në Rektorat për Komisionin e veçantë të ankesave të emëruar nga Senati.
- e. Për kushtet dhe aspektet e tjera të aplikimit vlejnjë pikat nga I deri VI të këtij konkursi.

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për emërim, riemërim ose avancim të personelit akademik janë të përcaktuara në dispozitat e Statutit të UP-së, Rregulloren nr. 886, të datës 27.4.2022, për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" për të gjitha Fakultetet përveç Fakultetit të Arteve, dhe Rregulloren nr. 887, të datës 27.4.2022, për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Fakultetin e Arteve dhe Rregulloren me nr. prot. 1/292, datë 29.5.2023.

II. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM

I. Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- a) Kërkesën për aplikim;
- b) Biografinë (CV);
- c) Certifikatën/ekstraktin e lindjes;
- d) Kandidatët që janë të punësuar në UP me rastin e konkurrimit për avancim në thirrjen akademike të profesorit asistent duhet ta dorëzojnë diplomën origjinale të doktoratës ose kopjen e saj të vërtetuar nga noteri, ose vendimin për nostrifikimin (barasvlerën) e diplomës së doktoratës/dëshminë e aplikimit për nostrifikim. Kandidatët të cilët konkurrojnë për riemërim në pozitën e asistentit, nëse nuk kanë doktoruar ende, duhet të sjellin dëshminë e regjistrimit të studimeve të doktoratës;
- e) Kandidatët që janë të punësuar në UP duhet të paraqesin vendimin e emërimit të fundit;
- f) Dëshmitë për: monografite; referencat përkatëse për mësimdhënie; tekste mësimore; pjesëmarrje në projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme; mentorime; pjesëmarrje në konferenca shkencore; publikimet shkencore e profesionale; shërbimin për Universitetin, fakultetin dhe komunitetin etj., brenda kornizës së përcaktuar me Statutin e UP-së dhe Rregulloren në fuqi për emërim, riemërim dhe avancim të personelit akademik. Linku: <https://dokumente.uni-pr.edu/>;

Kandidatët të cilët nuk janë të punësuar në UP, përveç dokumenteve nën pikat a), b) c) dhe f) duhet t'i sjellin edhe:

- g) Diplomat origjinale ose kopjet e diplomave (baçelor, master, magjistraturë dhe doktoratë) të vërtetuara nga noteri;
- h) Kandidatët që i kanë mbaruar studimet jashtë vendit me rastin e aplikimit për zgjedhje, rizgjedhje apo avancim duhet të sjellin vendimin për nostrifikimin (barasvlerën) e diplomës përkatëse (baçelor, master, magjistraturë, doktoratë) ose dëshminë e aplikimit për nostrifikim;
- i) Kandidatët që konkurrojnë për asistentë, lektorë dhe korepetitorë duhet të sjellin edhe certifikatën e notave të studimeve baçelor dhe master/magjistraturë;
- j) Kandidatët të cilët pretendojnë të themelojnë marrëdhënie të rregullt pune për herë të parë në UP, duhet të sjellin dëshmi nga Gjykata Themelore përmes së cilës dëshmojnë që nuk janë të dënuar dhe që nuk janë nën hetime;
- k) Dëshmitë për përvojën e punës të realizuar në institucione dhe programe të akredituara të arsimit të lartë;
- l) Informatat e tjera specifike shtesë, të cilat janë të rëndësishme për ata që aplikojnë; dhe
- m) Deklaratën me shkrim për gatishmëri të dorëheqjes nga vendi i punës paraprak në rast të emërimit nga Senati.

III. KOHËZGJATJA E EMËRIMIT DHE KUFIZIMET PËR EMËRIM


1. Të gjitha emërimet për tituj, si dhe kohëzgjatja e punësimit bëhen në përputhje me dispozitat përkatëse të Statutit të Universitetit të Prishtinës.
2. Avancimi përkatësisht riemërimi nuk është proces automatik, por është konkurrues dhe i bazuar në kriteret e Statutit të UP-së dhe të rregulloreve në fuqi lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik.
3. Në rast të mungesës së vendimit për nostrifikim të diplomës në kohën e aplikimit për emërim, riemërim ose avancim, kandidati është i obliguar që së paku 3 ditë para se Senati të vendos për lëndën përkatëse, të sjellë vendimin për nostrifikim të diplomës/ave, në të kundërtën kandidatura do të refuzohet.
4. Anëtarët e personelit akademik të cilët sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për zyrtarët publikë dhe Vendimit me nr. prot. 226, datë 18.2.2022 për përcaktimin e ngarkesës në punë dhe angazhimet në institucione/ndërmarrje publike apo private, vendore apo ndërkombëtare, brenda apo jashtë vendit të personelit akademik të Universitetit të Prishtinës, të cilët kalojnë në pozitën e bashkëpunëtorëve të jashtëm ose obligohen të pezullojnë vendin e punës, gjatë periudhës që ushtrojnë poste/funksione publike, nuk kanë të drejtë t'i nënshtrohen procedurave të konkursit të rregullt për emërim, riemërim dhe avancim. Nga ky kufizim përjashtohet personeli akademik i Fakultetit të Mjekësisë që mbanë pozitë të drejtorit të klinikës në kuadër të ShSKUK/QKUK-së dhe personeli akademik i zgjedhur në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
5. Në kuptim të zbatimit të pikës 6, 17 dhe 18 të Vendimit me nr. prot. 226, datë 18.2.2022 të KD-së, kandidatët të cilët pretendojnë të themelojnë marrëdhënie të rregullt pune për herë të parë në UP, nëse janë të punësuar në ndonjë institucion publik apo privat, ndërmarrje publike apo private brenda apo jashtë vendit dhe/apo persona tjerë juridik të cilësdo veprimtari apo status ligjor obligohen që para se të nënshkruajnë kontratë pune me Universitetin në Prishtinë, të sjellin dëshmi për dorëheqje nga vendi përkatës i punës.
6. Kriteri i moshës së përcaktuar në nenin 177 dhe 178 të Statutit vlen për kandidatët të cilët aplikojnë për themelimin e marrëdhënies së rregullt të punës dhe do të merret në konsideratë deri në ditën e përfundimit të konkursit. Nëse një kandidat ka qenë i angazhuar në Universitetin e Prishtinës në cilësi të bashkëpunëtorit të jashtëm apo me honorar para moshës së përcaktuar sipas nenit 177 dhe 178 të Statutit, kjo nuk nënkupton që për të njëjtin nuk aplikohet kriteri i moshës së paraparë me Statut në momentin e themelimit të marrëdhënies së rregullt të punës.
7. Bazuar në Ligjin e Punës në fuqi, kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vjet, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.
8. Në Universitetin e Prishtinës nuk lejohet rekrutimi/angazhimi i kandidatëve brenda ndonjëres prej strukturave themelore organizative (katedër, degë, departament ose program), nëse brenda atyre strukturave të njëjtit kanë në marrëdhënie të rregullt pune apo të angazhuar familjarë të ngushtë (në relacionin bashkëshortor, prind- fëmijë, vëlla-motër, motër-motër, vëlla-vëlla dhe anasjelltas).
9. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi në Republikën e Kosovës themelojnë marrëdhënie pune sipas Ligjit të Punës, nën kushtet dhe kriteret e përcaktuara me ligj të veçantë për punësimin e shtetasve të huaj dhe sipas konventave ndërkombëtare.

IV. VENDIMI, PERIUDHA E ANKIMIMIT DHE E PËRMBYLLJES SË KONKURSIONIT

1. Procedura e votimit në Senat për propozimet e Këshillit të Fakultetit lidhur me emërimin dhe avancimin e anëtarëve të personelit akademik bëhet sipas Rregullores së Punës të Senatit.
2. Anëtari i personelit akademik i cili ka vlerësim pozitiv nga instancat paraprake, por i cili nuk i fiton votat e nevojshme të anëtarëve të Senatit për avancim, mbetet në thirrjen e njëjtë.
3. Ndaj vendimit të Senatit në afat jo më larg se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas pranimit në dorëzim të njoftimit për vendim, mund të bëhet ankesë në Komisionin e Senatit për Ankesa dhe Parashtrësa, që shërben si instancë e parë dhe e fundit e ankimit në UP.
4. Konkursi për emërim, riemërim ose avancim të personelit akademik, duhet të përmbyllet me vendime përkatëse të Senatit të UP-së për të gjitha vendet e shpallura, në një periudhë jo më të gjatë se 175 ditë nga dita e shpalljes.
5. Për raste të veçanta para arritjes së propozimit në Senat, me kërkesë të Rektorit afati i të gjithë procedurës mund të zgjatet edhe maksimum në 30 ditë.
6. Nëse konkursi nuk realizohet në tërësi apo pjesërisht brenda afatit të përcaktuar si në paragrafin 4 të këtij neni, atëherë vendet përkatëse të përcaktuara mund të rishpallen në konkursin e radhës sipas kërkesës së Fakultetit.

V. MËNYRA E APLIKIMIT

1. Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentet e nevojshme në formë të shtypur dhe në formë elektronike.
2. Dokumentacioni i shtypur duhet të dorëzohet në Fakultetin përkatës, kurse versioni elektronik të ngarkohet përmes platformës online të Universitetit të Prishtinës stafiakademik.uni-pr.edu.
3. Punimet shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare nuk ka nevojë të skanohen në tërësi, por vetëm faqja e parë dhe e fundit e punimit (përfshirë konkluzionet), ndërsa për libra, tekste mësimore dhe monografi të botuara duhet të skanohet faqja e parë e librit dhe faqja në të cilën shihen recenzentët dhe katalogimi në botim (CIP).
4. Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara, si dhe ato që nuk deponohen të skanuara përmes postës elektronike në adresën e lartcekur, nuk do të merren në shqyrtim.
5. Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike, përkatësisht nga data **31.5.2023 deri më 14.6.2023, në orën 16:00**. Gjatë kësaj periudhe kandidatët e interesuar duhet të aplikojnë në formë fizike dhe përmes platformës online.

Kryesuesi i Senatit të UP-së:

Prof. Dr. Qerim Qerimi, rektor

